
REVISTË SHKOLLORE E M.M. "ALAUDDIN" PRISHTINË
Nr. 32 / Dhjetor 2011

DRITA e KUR'ANIT

نور القرآن

www.medreseja.com




Heshtja që s'na duhet

Rrugëtimi në Turqi

"Buzëqesh ti, gëzohemi ne"

Daniel Streich përqafon Islamin



Ardhmëria e vendit tim

Ju jeni ardhmëria e vendit tim
Që ngelet pa kulm mbi kokë
Ju vranë prindërit e mbetët jetim
E kush kah ju s'e kthen kokën dot!

Lotët që ju keni në sy
janë sikur shiu që s'ndalet
jetoni jetën në vetmi
e s'don askush t'ua dijë hallet


Jeni ata që përjetoni vuajtje...e di
Zemrat tuaja të njoma,
Gjejnë një copë strehë
Në një gjysmë shtëpi

Më qanë zemra e më djegë shpirti
Kur ua shoh gjendjen tuaj,
Mundësi tjetër t'u ndihmoj nuk kam
Pos që bashkë me ju edhe unë te vuaj

I Madhëruari Allah lutjen time pranoje
Çdo fëmijë jetim në këtë botë me Xhennet begatoje
Jetën e tyre ne çdo aspekt lehtësoje
Mungesën e prindërve me shpërblimet tua zëvendësoje

Largoje prej tyre vuajtjen e mërzinë
Që tash bashkë me të rrinë
Shndërroji jetët e tyre në hare e gëzim
Që më në fund të gëzohen këta jetim

Burhanudin Kukaj IV



PËRMBAJTJA:

3 - Fjala e Kryeredaktores
4 - Heshtja që s'na duhet
5 - Ty Palestinë / Më fal nëna ime
6 - Melodi në mesnatë
8 - Momente nga eskursioni në Turqi
9 - Pesë kategoritë e njerëzve në namaz s...
10 -11 Trajtimi i mbulesës dhe lëndës fetare ...
12 - Thënie të menqura
13 - Si ta shijosh namazin
15 - Pse ekzistoj
16 - Do të bindeni dikur
17 - Jeta
18 - Thjesht "Pse Jo"
19 - Ty Palestinë / Më fal nëna ime
20 - Pa gjysmën e shpirtit tim
22 - Dua më shumë se gjithqka
23 - Rrugëtimi në Turqi
24 - Shqiptarët dhe vendet e shenjta
26 - "Buzëqesh ti, gëzohemi ne"
27 - Kuriozitete
28 - 30 Aktivitete në shkollë
31 - 33 Shkencë dhe Teknologji
34 - Fjalkryqi
35 - Daniel Streich përqafon Islamin

FJALA E KRYEREDAKTORES

Falënderojmë Allahun e Madhëruar, që na mundësoi ta jetësojmë edhe një ëndërr ,realizimin e këtij numri të revistes, ndërsa përshëndetjet tona të përzemërta qofshin për Të dërguarin mëshirë për mbarë njerëzimin, Muhamedin a.s.

Meqë punët dhe veprimtaritë kërkojnë zell dhe angazhim, domosdoshmërisht edhe kjo revistë mund të themi se vazhdon të sheh dritën e botimit, falë punës së palodhshme të nxënësve të shkollës sonë.

Këtë angazhim dhe aktivitet e bëjnë të begatshëm të gjithë ata lapsa kreativ dhe të gjitha ato imagjinata të shkëlqyera të nxënësve të Medresesë.

Revista "Drita e Kur'anit" vazhdon të përqojë mesazhe edukuese dhe kulturore tek bashkëmoshatarët tanë në tërë vendin. Kjo revistë është zëri që artikulon mirëfilli mësimet që merren nga ne në këtë burim të dijes.

Njëherësh, ne përzemërisht falënderojmë drejtorin e shkollës Bahri ef. Simnica , I cili nuk heziton të na ndihmojë në iniciativat tona të mbara. Gjithashtu falënderojë edhe profesorët që na ofruan përkrahje, e në veçanti antarët e redaksisë për angazhimin e tyre të shtuar në këtë drejtim.

Kjo që ne kemi ofruar për lexuesit është vetëm një shkëndijë nga drita edukuese që kultivohet në qërdhen tonë të diturisë, andaj shpresojmë që shkëndija të tilla të vazhdojnë të dalin nga këtu përgjithmonë.

Kryeredaktore:
Albulena Hajraj


Redaktor:
Ensar Halimi

Redaksia:
Burhan Kukaj, Elton Sylmetaj, Vjosa Statovci, Fanol Kashtanjeva, Xhevdet Rizahu, Besa Kqiku, Arti Mahalla, Adhurim Tolaj, Eliza Bublaku, Fatjon Osmani, Jasir Krasniqi, Anita Gerguri.

Redaktore gjuhësore:
Shahë Memishi

Dizajn:
Bashkim Mehani

E-mail: ***redaksia_v@ hotmail.com***
redaksia_d@hotmail.com
www.medreseja.com



HESHTJA
që s'na duhet !

Ne heshtim përpara një bote e cila vazhdimisht flet.

Ajo nuk ndalet pa marrë parasysh gjendjen tone. Ajo prapë flet.

Është për tu çuditur me myslimanët. I harrojnë obligimet e tyre dhe veprojnë gjëra të dorës së dytë, apo edhe më larg. Sa lehtë e keqja na pushton zemrën tonë dhe sa vështirë është për të duruar karshi një veprimi të dikujt tjetër.

Sa shumë njerëz gjykojnë pa i menduar shkaqet dhe arsyet. Sa herë jemi fyer nga dikush që nuk e di se ç'do të thotë cilësia e durimit. Ne jemi të vegjël karshi një bote gjigante.

I forti po e sundon të dobëtin, të pasurit po jetojnë pa qarë kokën për të tjerët që po vuajnë për një kafshatë buke.

E keqja ka pushtuar mendjet, zemrat dhe trupat e njerëzve të pamëshirshëm.

Ai civilizim që ne po e quajmë "Perëndim" na e ka shkatërruar edhe atë pak edukatë që patë mbetur nga të parët tanë.

Ne thjeshtë po vrapojmë drejt një rruge që fundi nuk i shihet.

E kur fundi mbetet enigmë në mendjet tona, frika dhe dëshpërimi do të jetojnë me ne karshi premtimeve të kota të njerëzve të padrejtë.

Prej padrejtësisë fiton dikush e dikush humb. Humb ai që e ka marrë padrejtësinë si mënyrë jete, kurse fiton ai që padrejtësinë e ka cilësuar si veprën më të keq.

Me veprimet tona botës nuk mund t'ia mbyllim gojën. Ajo përsëri do të flas, derisa ne të kuptojmë qëllimin.


E kur ne të kuptojmë se përçarja nuk duhet të ekzistoj mes myslimanëve, bota do të heshtë dhe do të pres lëvizjen tonë të radhës. Ne duhet të tregohemi syçelë, por si duket bota qenka aq e madhe sa që arma jonë më e fortë duhet të jetë edukimi i njerëzimit. Atëherë, kur njeriu do të kuptoj qëllimin e krijimit, do të jetë e lehtë ikja prej civilizimit, atij civilizimi degjenerues, e për njerëzimin shkatërrues.

Nuk duhet të heshtim e të qetë të jetojmë e shtiremi sikur asgjë s'duhet të punojmë. Por jo!

O myslimanë: ngritni zërin dhe me drejtësi punoni, veproni ashtu siç jeni porositur të bëni! Mos u mashtroni nga ata që me dy fytyra ju paraqiten, por besoni vetëm Atij që ju krijoi juve dhe di gjithçka që ju nuk e dini!

Besa Kqiku **IIIv**

Në bus



Hapë çantën, merr kuletën

Mbyllë çantën,hapë kuletën

Merr lekët, mbyllë kuletën

Jep lekët, merr biletën

Hap kuletën, futë biletën

Mbyll kuletën,hapë çantën

Futë kuletën, mbyllë çantën

Sara Halili 11v

Ty Palestinë

Ende nuk u ndal britma e fëmijëve, të cilët në vend të lodrave luajnë me plumba, në vend të familjareve të tyre shoqërohen me vetmin e jetimeve, dhe toka në të cilën ata ecin, është ujitur me gjakun e dëshmorëve që vazhdojnë të ta falin jetën, ty Palestinë.

Jemi te paaftë te të ndihmojmë, edhe pse këtë e dëshirojmë. Nuk mund të jemi pran teje, pikërisht tani kur ke nevoje. Zemrat tona vuajnë bashkë me tuajat.

Ende nuk u ndal dhimbja për ju, ende nuk u ndal vuajtja që ju e ndjeni,

por ende vazhdojnë duatë tona të sinqerta që për ju i themi.

Fatlume Çitaku 12 v

Më fal nëna ime

Mora lapsin dhe një copë letër të grisur dhe në atë çast më pikoi një lot më ndryshe, sepse sa herë që shkruaj për ty jeta më duket ndryshe. Sikur ndihem më e lumtura në botë të fluturoj e lirë.


E di që nuk mjaftojnë as fjalët që të përshkruaj ty, sepse ti je qenia më e butë njerëzore më fytyrë engjëlli. Në jetën time e mora qëndrimin e duhur, vendim që nuk kërkon kohë për t'u menduar dhe ky vendim ngulitët mu në zëmër që të mos lëndoj, sepse ti nënë e shenjtë je e vetmja që më drejton në rrugë të drejtë. Kur në sytë e tu pikon loti, më dukët sikur një pjesë ë zëmrës po largohet.

Prandaj, o nënë mos qaj as për të vetmen gjë, sepse lotët e tu edhe mua më mundojnë. Nënë nëse të kam lënduar pa dashje, të lutëm më fal, së unë e di që një shpirt nëne falë shumë. Më fal nënë, sepse ti je ajo të cilën e desha e dua dhe do ta dua përgjithmonë.

Hysnie Hyseni 11v

MELODI NË MESNATË

Melodi... Për herë të parë e kam dëgjuar nga buzët e nënës sime dhe e përvetësova në shpirtin tim. Nga kjo melodi shpirti më ishte kënaqur. Sikur një mes meje dhe lumturisë. Me këtë zë u shua, u copëtua dhe u fshi ai mur i lartë, ai mur u zhduk me pafundësi. *El-hamdu-lil-lahi rab-bil alemin*"- shqiptonin buzët e nënës sime.



Sytë e saj shkëlqenin nga një dritë brilante ndërsa shikimin e kishte të thellë. Në brendinë e saj rregullisht ku ndonjëherë lëshonte një zë dhe thërriste "Eja"!Një vijë, një gjurmë, rrugë e hollë. Kjo rrugë fillonte me "Falënderimet i takojnë Allahut, Krijuesit të Botëve". Duke e Falënderuar Atë fillonte. Pra, pa u përkulë a mund të zhytemi në brendinë tonë?! Pa u përkulë a mund të shohim veten dhe të vështrojmë zemrën?! Pa dyshim që jo. Pastaj shikimet e nënës sime ishin në një gjendje tjetër. Thellësia sa rritej dhe zgjerohej, duke iu afruar pafundësisë.

"Err-Rrahmani Rrahim" ishte ajeti që doli nga buzët e saj. Si një muzikë e ndritshme rrodhen këto fjalë të ndritura që derdheshin në krahët e saj. Unë duke shikuar në sytë e saj, nuk mund të duroja pa i mbledhë këto fjalë të ndritura që derdheshin në krahët e saj. Këto Fjalë ishin më të vlefshme se xhevahiret, më të zgjedhura. Aq shumë ndriçonin, sa nuk mund ta përshkruaja.

Pastaj, *"Maliki Jevmid-din"*, - thoshte nëna. "Sunduesit të Ditës së Gjykimit" - thoshte, Allahu është Sundues i Ditës së Gjykimit. Pra, ditës së vërtetë. Ajo ditë do të jetë një ditë e tmerrshme, ku çdo gjë do të ndahet e mira dhe e keqja, errësira nga drita, shëmtia nga bukuria, dhimbja dhe kënaqësia. Nga zemra e saj bëheshin mysafir të syve dhe pastaj duke marrë melodi ndriçuese nga buzët, ktheheshin në botën tonë.

Pastaj fjalët: *"Ij-jake-na' budu ve ij-jake nestein"* rrodhën si një oazë në zemrën time. Kjo fjali posedonte fuqi, ndjeshmëri dhe magjepsje për t'i bërë njerëzit për vete. "Vetëm Ty të Adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. "Pronari i Gjithçkaje e shpëtonte robin nga lypësia. "Ti je i imi dhe nuk të lëshoj dhe nuk të lëshoj" thoshte. "Nuk do të lë në dorë të analfabetëve, të pafuqishmëve, të varfërve që të shkatërrojnë" - thoshte dhe na afronte pranë vetës. Ua siguronte shpirtin dhe zemrën. Këto fjalë, shpirtit tim i erdhën në shkretëtirë si ujë i ëmbël. E piva ilaçin nga këto fjalë dhe ndjeva freski në buzët e mia dhe një gjallëri në zemrën saqë e bëri të humb vetën. Kur u këndella e vërejta se kisha kaluar në një dimension tjetër.

"Ihdinassiratal-muskekim" - thoshte nëna. Kjo fjalë neve na tregonte një vijë të drejtë. Po duke thënë "ti je i vetmi, ju jeni të mitë" Zoti kërkonte nga ne të jemi në rrugë të drejtë. Nëse kjo nuk ndodh atëherë ne nuk do të arrijmë tek Ai, sepse në fillim

një devijim i vogël, në të ardhmen duke të shkaktuar, të largon nga rruga e drejtë. Kjo vijë e drejtë, si një busulle e tërhoqi zemrën drejt një agimi. Dhe mua më lidhi me të vërtetën si me zinxhirin e me pranga e më robëroi. Ky ishte dorëzimi para Zotit. Dhe ishte burimi i lirisë dhe lumturisë. Ah sikur ky dorëzim të vazhdonte përherë, deri sa të hyjmë në xhennet. Ky zinxhir si një mik i vërtet të më mbaj të lidhur dhe mos të ndahet nga unë.

Një shpjegim filloj përsëri: "Siratal-ledhine en'amte alejhim" shpjegonin buzët e nënës. Shikimet kaluan në botën tjetër. Kur shikoje, shihje një vijë të ndriçuar që zgjatej drejt të Vërtetit, mbështetej në derën e riskut dhe e kuptonte që çelësi për të hapur atë derë është një çelës magjik. Por, kodi ishte drejtësia. "Neve na udhëzo në rrugën e drejtë, që iu ke dhënë begati e mëshirë në rrugën e pejgamberëve, të devotshmëve. "

Kjo edhe neve sikur na thotë, "Ju përgjërohemi në këtë mënyrë, kjo është duaja më e mirë" duke na këshilluar. Në atë çast buzët e mija përsërisnin këto fjalë me një vullnet të tjetërsuar. Kjo shpallje hyjnore ishte e fortë si një muxhize (mrekulli) dhe jetën do ta kthente në një gjendje të mëshirshme dhe atë do ta pastronte nga të gjitha të këqijat, sherri dhe kaosi.

U hutova nga fjalët e shqiptuara nga nëna *" Gajril magdubi alejhim"*. Kjo ishte një paralajmërim, kjo ishte një këshillë për të mos u futur në gabime.

Me këtë fjalë ndjeva një gjendje kënaqësie sikur me mijëra drita të kuqe vinin nga një erë zjarri, nga një dhimbje e vullkanit, nga një tendë e dhembjeve, nga një vend i vuajtjeve. Apo prej atij apelohej. "Mos ejani këtu, mos e mundoni vetën për një fund tragjik".

Pastaj, një fjali u derdh nga buzët e nënës *"Veled-dal-liin"*. Ky ishte një paralajmërim më i frikshëm. Ky paralajmërim sikur vinte nga një gropë e thellë, qe nuk i shihet fundi, apo nga një xhehenem i mbushur me zjarr. Ata para nesh ishin në humbje e devijim, që e meritonin zemërimin e Allahut. Edhe mëkatarët ishin në mesin e këtyre. Por, në fund me fjalën "Veled-dal-lin", etiketoheshin si një grup i devijuar nga rruga e drejtë. Shikoja në sytë e saj në atë çast. Një natë e thellë, sikur vesa mbulonte. Nëna qante dhe lutej duke thënë: "Mos na bëj prej këtij grupi o Allah"! Mua më lotonin sytë që të mos bëhesha pjesë e këtij grupi, iu luta Allahut. Mu në atë çast buzët nënës thanë "Amin".

Bylbyl Hajdamataj II



KUJTOJE ALL-LLAHUN

Kujtoje ALL-LLAHUN
Krijuesin e gjithësisë
Falënderoje ALL-LLAHUN
Burimin e mirësisë
ALL-LLAHUN e kujtoj
Zemrën ma qetëson
ALL-LLAHUN e falënderoj
Shpirti më freskohet.
Kujtoje ALL-LLAHUN
Përplot dashuri
Falënderoj ALL-LLAHUN
Për gjithë begati.
ALL-LLAHUN e kujtoj
Nëpër dallgë e stuhi
ALL-LLAHUN e falënderoj
Të vetmin Perëndi.
Kujtoje ALL-LLAHUN
Që është Dritë mbi dritë
Mbi tokë është veç Ai
Që është i vetëm i vërtetë.

Lulzim MEHAJ 11a

Momente nga ekskursioni në Turqi

Nga përvojat më të pa harruara ishte edhe ekskursioni në Turqi, i cili na la përshtypje të mallëngjyeshme. Ishte moment i pa zëvendësueshëm, i pa harruar dhe i pa përsëritshëm.

Të tubuar në aeroportin e Prishtinës së bashku me paralelet e ndara fizike iu drejtuam aeroplanit dhe u nisëm për në Turqi. Më të arritur në Turqi, shihej qartë se gjithçka ishte ndryshe. Në radhë të parë u ndie një ndjenjë e mrekullueshme kur në aeroportin Ataturk të Stambolit, gjendej një vend i veçantë për ta falur namazin. Pritja e udhërrëfyesve tanë me dy autobus që i kishte mundësuar komuna e Pendikut ishte shumë mbresëlënëse. U nisëm për në konviktin e shkollës *Anadolu Imam Hatip Lisesi*, shkollë kjo që ishte edhe nikoqiri ynë gjatë qëndrimit tonë në Stamboll. Ai gjendej ne Kartall të Stambollit. Shihej një infrastrukturë e shkëlqyer në të gjitha dimensionet.

Po të përshkruanim gjithë atë që kemi vizituar e parë, ndoshta mund të ishte bërë një libër i tërë.

U pritëm jashtëzakonisht mirë, pavarësisht se ne ishim nxënës. Shoqërues kryesor kishim një njëri shumë modest, e ai ishte Metin Tavukcoullu, i cili i kishte shoqëruar gjatë gjithë kohës. Gjatë qëndrimit tonë në Turqi vizituam tri qytete: Stambollin, Bursën dhe Çanakalanë. Që në ditën e parë shkuam të falim namazin e sabahut në xhamin *Sulltan Ejub El-Ensariu*, e kshtu më rradhë në *Ulul Cami* (Bursa), *Emineni Cami*, *Sulltan Mehmet Fatih*, *Aya Sofia* e shumë të tjera. Pastaj u takuam me kryetar, zëvendës kryetar e mufti të komunave të ndryshme p. sh. Dr. Salih Kenan Sahin, kryetar i komunës së Pendikut, Recep Altepe kryetar i Bursas, pastaj me myftiun e Pendikut, me dijetarin e njohur të Turqisë Osman Nuri Topbash e kështu me rradhë. Vizituam edhe qarshitë e qyteteve dhe shumë vende tjera.

Gjatë qëndrimit tonë në Turqi ne u njohëm me një civilizim, me një kulturë, me një arkitekturë shumë shekullore. E gjithë kjo që u tha, shumëçka ka mbetur në zemrat tona që nuk mundë të shprehet me fjalë. Ky udhëtim do të mbetet i pa harruar dhe i pa zëvendësuar për ne.

All-llahu i shpërbleft të gjithë ata të cilët kontribuan në këtë ekskursion që mos të shlyhet nga zemrat tona - Amin.

Ensar HALIMI IV



Pesë kategoritë e njerëzve në namaz sipas Ibn El Kajimit

Kategoria e parë - Kësaj kategorie i përkasin ata që janë mizorë ndaj vetvetes, të shkujdesur, që e lënë të mangët abdesin, kufijtë dhe shtyllat e namazit. Sipas Ibn Kajimit, kjo kategori është e ndëshkuar.


Kategoria e dytë - I kësaj kategorie është ai që kujdesët për kohët e namazit, për kufijtë dhe shtyllat e tij, për abdesin, por e ka humbur xhihadin me vetën e tij për të përballuar vesveset, të cilat e preokupojnë në namaz bashkë me mendimet. Për këtë kategori Ibn Kajimi thotë se është e llogaritur.

Kategoria e tretë - Këtu hyn ai që kujdesët për kufijtë dhe shtyllat e namazit dhe bën xhihad me vetën e tij për të larguar vesveset dhe mendimet. Xhihadi i tij ishte po aq i fortë si të ishte në dyluftim me armikun dhe kujdeset që të mos i vidhet namazi i tij. Ibn Kajimi thotë se këtij personi të kësaj kategorie do t'i shlyhen mëkatet.


Kategoria e katërt - I kësaj kategorie është ai njeri që kur fal namazin, i plotëson të drejtat e tij, shtyllat dhe kufijtë e tij, zemra e tij është përqendruar duke u munduar të jetë sa më korrekt ndaj asaj që kërkohet, në mënyrë që të mos i humbë asgjë pa e praktikuar. I gjithë preokupimi i tij është që të fal namazin ashtu siç duhet, duke e plotësuar dhe kompletuar atë. Kjo është zemra e përqendruar në namaz dhe adhurim ndaj Krijuesit të vet. Për këtë kategori Ibn Kajimi thotë se është e shpërblyer.

Kategoria e pestë - Njeriu që bën pjesë në këtë kategori i ngjan atij të kategorisë së katërt, por megjithatë e ka vendosur zemrën mes duarve të Krijuesit të tij duke shikuar nga Ai, i madhëruar qoftë, si të jetë duke e parë Atë e ka zemrën të mbushur me dashuri dhe madhëri të Tij. Ai ka shuar vesveset dhe mendimet, diferenca mes tij dhe tjetrit në namaz është shumë më e madhe se sa mes tokës dhe qiellit. Ky në namazin e tij është i lidhur me Krijuesin e tij dhe syri i pushon në Të. Kjo kategori është afruar te Krijuesi i vet.

Festim KLINAKU 10a



Trajtimi i mbulesës dhe lëndës fetare nga qarqet shtetërore në Kosovë



Shteti sipas të kuptuarit klasik dhe bashkëkohor ka të pranuar më së shumti dy kuptime me domethënie si:

-një grup mendimtarësh mendojnë se shoqëria-shteti është formë e jetesës së përbashkët, mënyra e konfirmuar e ekzistimit të bashkësisë njerëzore;

-të tjerët shtetin e sjellin në njërin nga elementet e tij, pra *pushtet*, në organizimin e detyrimit, në aparaturë korrektuese ose aparaturë të bashkëpunimit të detyruar. [1]

Në kuptim të asaj që u tha më lartë, njerëzit në botë ose kanë dëshirë të jetojnë në njërën nga këto dy performime shtetërore, ose janë të detyruar ta bëjnë një gjë të tillë.

Mirëpo, kur me një formë ose tjetër je pjesëmarrës i shtet ndërtimit, atëherë gjërat edhe përjetohen edhe reflektohen më shumë.

Republika e Kosovës, shteti dhe vendi im

Republika e Kosovës është shteti që për disa kohë mbajti epitetin e shtetit më të ri në botë dhe pa mëdyshje ishte edhe nën vëzhgimin e shumë organizmave ndërkombëtar, se si dhe sa po ngritën aparaturat dhe vlerat e veta shtet formuese si shtylla kryesore duhet të i ketë: ligjin, lirinë dhe sigurinë, me të cilat funksionon dhe kultivohen parimet demokratike.

Shteti është i obliguar në mënyrë eksplicite t'iu përmbahet ligjeve, që shoqëria e atij shteti të jetë sa më rehat, sa më komod, sa më të sigurt në shtetin e vetë. Si çdo

1 Përgaditi: Prof. Dr. Fikret Karqiq, *Religjioni dhe e drejta*, Sarajevë, 2004. fq.80.

qytetar i atij shteti ku funksionojnë ligjet dhe të drejtat, ai ka të drejtë të kërkoj të drejtat që i zotëron në bazë të ligjit, apo më mirë ta quajmë në bazë të kushtetues së atij shteti. Kushtetuta është shtylla e shtetit (themel i shtetit). Pa kushtetutë nuk ka shtet e pa shtet nuk ka civilizim të mirëfilltë.

Qëllimi i analizës dhe e gjithë esenca e kësaj teme (këtij fenomeni) të cilën do ta shtjellojmë është në rreshtin e fundit të paragrafit të parë e që ka shumë rendësi për shoqërinë në përgjithësi e në veçanti për shoqërinë e re kosovare.

Mirëpo, jemi dëshmitarë se kohëve të fundit, në shoqërinë Kosovare po lakohën frazat si: a është e nevojshme edukata fetare dhe shamia në shkollat shtetërore? Kosova është shtet i cili sipas statistikave ka afërsisht 95% e popullsisë me përkatësi fetare islame dhe me trashëgimi shumë të pasur kulturore e tradicionale fetare myslimane dhe konfesioneve tjera. Popullata kosovare është shumicë absolute e përkatësisë myslimane dhe është fakt që nuk duhet të neglizhohet.

Përkundër kësaj edhe pse shteti i Kosovës është me shumicë myslimane dhe historikisht ka dëshmuar tolerancën ndërfetare, vazhdimisht po trumbetohet se jemi shtet LAIK dhe nuk kemi të bëjmë me fenë dhe ! Kjo na bënë përshtypjen se fetarët janë disi ndryshe, të huaj, jo të nevojshëm, dekadent e fraza tjera të ngjashme.

Mirëpo, shteti i së drejtës duhet të bëjë përpjekje maksimale që tua bëjë me dije të gjithëve, se teoria e edukimit duhet të *trajtohet si* nevojë e domosdoshme edukativo-arsimuese. Shteti si instrument i sundimit, ka dy detyra themelore të cilat teoria e edukim-arsimimit vetëm se i *konstaton*. Ato dy detyrat janë:

a) të **ruaj** të **drejtën** natyrore të çdo njeriu në edukim dhe arsimim, domethënë të mundësojë institucione arsimore të domosdoshme për të gjithë qytetarët e vetë dhe

b) të siguron **financimin** e sistemit shkollor.

Nëse ndalemi dhe analizojmë detyrën e parë, do të shohim se është i mbrojtur edhe me **Nenin 6 ku thotë: "Çdo qenie njerëzore dhe çdo bashkësi ka të drejtë të jetojë i lirë, pa shtypje dhe për detyrë e ka që mos t'i shtypin të tjerët. Kanë të drejtë të kërkojnë prej të tjerëve që t'i respektojnë ato të drejta, sikundër është edhe detyrë e tyre që të mos i shkelin të drejtat e të tjerëve".** [2]

Trajtimi i lëndës fetare në shkolla publike

Sipas gjithë asaj që po dëgjohet neper media e intervista televizive thonë se, ne nuk jemi shtet i cili ka të përcaktuar religjionin fetar mysliman, të krishterë, apo edhe fe të tjera, pasi që me kushtetutë të Kosovës jemi të shpallur shtet laik.

2 Adbulhasen beni Sadr, *"Kur'ani dhe të drejtat e njeriut"*,fq.20-21.

Mendimi tjetër thotë se ai i cili dëshiron të ndjek mësim-besimin, duhet ta bëjë atë në shkolla përkatëse që janë si medresetë e kështu me radhë. Sipas tyre ata që duan shkollim fetar, duhet të vazhdojnë mësimin në shkolla fetare e kurrsesi në shkolla publike. Por, sa është kjo e drejtë dhe sa është humane?! Thonë se e drejta fetare nuk po u cenohet, ngase ata kanë shkollat përkatëse. Logjika e tillë diskriminuese tënton që tua imponojë drjtimet të gjitha atyre që I janë përgjigjur një urdhëri islam, dhe kanë vendosur shami mbi kokë. Ktu vetëm fillon esenca e problemit.

Sipas të dhënave, shumica e vendeve të Bashkimit e Evropian në përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës dhe shumë pak vendeve tjera nuk e kanë të futur mësim-besimin në shkolla publike. Pse në Kosovë nuk ka mirëkuptim për lëndën e edukatës fetare, kur në të gjitha vendet e tjera kjo lëndë po i pasuron nxënësit ne informacion, kulturë, tolerancë dhe mirëkuptim fetar?!

Trajtimi i hixhabit (shamisë) në shkolla

Veshja dhe mënyrat e të veshurit nuk do të duhej të ishte "mollë sherri", për ata të cilët e kanë normatizuar ligjet në Kosovë. Por, mënyra, përkatësisht nevoja e veshjes e ngërthen në vete qëllimin primar që padyshim se të tillat femra synojnë fisnikërinë njerëzore.

Arsyetimi i tyre për ndalesën e hixhabit nëpër shkolla është se ne nuk jemi shtet arab, kjo është kthim dhe një dekadencë që s'duhet hapur rrugën së paku nepërmes legjislaturës sonë zyrtare.

Justifikime të tilla do të vazhdojmë t'i ndëgjojmë edhe më tej nga njerëzit e lëkurës dhe gjuhës sonë, përderisa averzioni dhe stereotipet ndaj islamit mbulojnë mendjet e tyre.

Gjërat do të ndryshojnë gjithsesi, por vetëm atëherë kur ne të arrijmë t'ua bëjmë me dije çiltërsinë e synimeve tona të gjithë atyre që se ndiejnë veten komod nën petkun e mirëfilltë të islamit.

Literatura e konsultuar:

Adbulhasen beni Sadr, *"Kur'ani dhe të drejtat e njeriut"*, Gjilan. 1994.

Halit Muharremi, *Fjalori i teologjisë*, Mirgeeralb, Tiranë, 2006.

Përgaditi: Prof. Dr. Fikret Karqiq, *Religjioni dhe e drejta*, Sarajevë. 2004.

Ajni Sinani, *Islami besim ligj, kulturë dhe qytetrimë*, Prishtinë, 2007.

Alija Izetbegoviq, *Deklerata islame*, Prishtinë, 1999.

Ensar Halimi XIII

THËNIE TË MENÇURA

**Mos thuaj kurrë se ëndrrat janë të kota, sepse e kotë është jeta e atij që nuk ëndërron*

**Nëse rrezikon mund të humbasësh. Nëse nuk rrezikon ke humbur gjithsesi…!*

**Respektoi njerëzit kur je duke u ngjitur, pasi mund ti takosh ata përsëri duke zbritur !*

**Askush nuk është bërë i varfër duke dhënë (sadaka).*

**Një ndër ushtrimet më të mira për zemrën është të përkulesh, dhe të ndihmosh dikë që ka nevojë.*

**Ai që s'ka pasuri është i varfër, por me i varfër është ai që s'ka gjë tjetër veç pasurisë.*

**Dora e cila nuk shkruan, është këmbë.*

**Ne jetën e çdo njeriu vjen çasti kur ai e kupton se lakmia lind nga padituria.*

**Dituria shpie ne vepra, ndërsa puna te shpie ne mirësi.*

**Kjo bote është treg me te cilën blihet bota tjetër.*

**Është e pamundur qe njeriu te mësoj diçka që mendon se e dinë.*

**Morali më i mirë është miku më i afërt.*

**Ai që vdes dhe është qetësuar me vdekjen e tij nuk është i vdekur.*

**Më mirë është ta shpenzosh një qiri të vogël se sa tere jetën ta kalosh në terr.*

**Me mirë një vdekje si njeri se sa një jete si kafshe.*

Vesel Sylejmani 11

Eliza Bublaku 11



SI TA SHIJOSH NAMAZIN?

Si ta shijosh namazin është synim i çdo myslimani.

Mendojnë se kjo çështje është e ekzagjeruar, nuk është e tillë, secili mund ta shijoj këtë kënaqësi.

Nuk është përkulja në namaz vetëm për ato që janë të mbuluara apo për fetarët.

Kjo është mirësia e All-llahut që ia jep kujt do.

Secili ka dëshirë që të përulet në namaz, t'i ndal vesveset dhe mendimet, në mënyrë që ta shijoj ëmbëlsinë e namazit.

Përkushtimi në namaz nuk është tërësisht i njëjtë tek të gjithë besimtarët.

Pejgamberi(s.a.v.s) ka thënë: *"Gjëja e parë që do të humbisni prej fesë suaj është përkushtimi, ndërsa ajo e fundit është namazi..."*(hadith).

Namazi pa përulje është sikur trupi pa shpirt.

Është shumë e vështirë që njeriu ta parafytyroj lumturinë që do ta arrijë në çdo namaz të tij, këto janë momente që nuk kanë çmim.

Që ta arrijë njeriu një rekat, në të cilin lidhet me të vërtetë me All-llahun është më e mirë se kjo botë dhe çka ka në të. Mirëpo, nuk duhet të jetë përkushtimi brenga jonë e vetme para se te hyjmë në namaz.

Duam më shumë se kaq

Duam të provojmë një ndjenjë tjetër, e cila i bëri fytyrat e sahabëve që të ndërrojnë gjatë namazit. Frika dhe madhështia...

Këtë e jetojnë melaiket,e si mos ta ndjejmë ne atë?!

Thotë Pejgamberi (s.a.v.s): *"Kalova në natën e Isras dhe Mi`raxhit kah paria më e lartë, e Xhibrili ishte sikurse pupla e ngrirë nga frika e All-llahu (s.v.t)."*

Gjithashtu ka thënë Pejgamberi (s.a.v.s): *"Për Zotin, sikur ta dinit atë që e di unë, do të qeshnit pak, e do të qanit shumë"*.

"E për ata të cilët i kanë shijuar këto ndjenja, çfarë u ka ndodhur atyre ?!

"Ali ibn Ebi-Talib kur ishte në namaz dridhej dhe i ndryshonte ngjyra e fytyrës së tij, i thuhej atij: Çfarë ke? - thoshte: "Për Zotin erdhi koha e kryerjes së amanetit, të cilin All-llahu ia afroi tokës, qiejve dhe kodrave, refuzuan që ta pranonin atë, dhe u frikësuan nga Ai dhe e pranova atë unë."

A do të mund të vepronim edhe ne kështu? Të paramendojmë se tani do t'i drejtohemi një Zoti shumë të Madh, i Cili është para teje, ti i flet dhe Ai të përgjigjet.

Shiko shembullin e prezantuesit kur i jepet shenja se është drejtpërdrejtë në emision.

Pse fokusohet e ndoshta edhe stresohet edhe pse nuk e sheh askënd nga shikuesit?!

Por ai ka bindje se tani është dikush para tij që po e shikon.

Ashtu edhe ti duhesh të bindesh se para teje është Dikush.

"Ta adhurosh All-llahun sikurse po e sheh edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty "(ihsani).

Drejtoi fjalët nga brendia e zemrës tënde.

Thotë Ibn Kajjimi: "Pas çdo ajeti ndalo pak, ashtu që All-llahu të të përgjigjet."

Muhammedi a.s thotë, All-llahu i Lartësuar ka thënë: *"Namazin e kam ndarë mes Meje dhe robit Tim përgjysmë, robit i takon ajo çfarë ai kërkon."*


Ndjenjat tona në namaz duhet të jenë edhe ndjenja të dashurisë. E dashuria më e ëmbël që ekziston është ajo e All-llahut.

All-llahu e do atë, që e do Atë. Sa më e fortë të jetë dashuria e robit për All-llahun, dashuria e All-llahut është më e madhe për robin.

Dënimi më i madh për shpirtin është që të largohet nga dashuria e All-llahut.

Mund ta përfundojmë me një thënie të bukur të Ibn Kajjimit : ". .. kënaqësia vie pas ndjenjave dhe dashurisë, sepse sa më shumë ta njoh të dashurin dhe ta dojë Atë më shumë do jetë kënaqësia me afërsinë ndaj Tij më e madhe."

Punuan:
Jetmira Vishesella 13v
Vlora Sopjani 13v
Fatime Murina 13v



PSE MBULESA?

Kështu qenka kjo jete
Vetëm me ngatërresa
Ne çdo të dytën fjalë
Te thonë: Pse Mbulesa?!

Nganjëherë dua te nisem ne një rrugë
Nga e cila nuk dua kthim,
Sepse këto fjale të kota
Mendoj se kurrë nuk do të kenë mbarim.

Dua te thërras me zë te lartë
E të me dëgjoj e gjithë njerëzia,
Mbulesa nuk të bënë njeri
Por është obligim nga Perëndia.

Të ndalemi pak për të menduar
Të gjitha gjërat e vlefshme në botë
A nuk janë të mbuluara ?

Ti moj motër atje ku je ...
A e din sa shumë vlerë ke ?
Krenohu ti me këtë shami
Allahu te shpërbleftë ne xhennetet e Tij. !

Anita Gerguri 10v

PENDIMI

Kur nata pushtoi qytetin,
gjumë në sy nuk kisha unë.
Trupi mu rrëqeth
kur vdekja mu kujtua.

Menjëherë sytë mu mbushëm më lot,
duke mos ditur
se kur do të ndahem nga kjo botë.


Mendova se qava, qava aq shumë
sa që, më zuri gjumi.
Ende pa rënë në gjumë
qava për kohën e kotë,
të cilën e lash pas,
duke e lutur Allahun të më falë.

Të falënderoj o Zot, që më solle në dritë.
Kisha qenë e humbur dhe këtë nuk e kam ditë.

Ti o Perëndi, që krijove gjithësinë.
Ti që krijove dhe mbarë njerëzinë,
më fal Ti o Zot, se tani u pendova.
Ditën kur do dal para Teje
më lot e kujtova.

Tani TY të falem
dhe TY të falënderoj
duke shpresuar së bukuritë e Xhennetit,
dhe unë t'i shijoj.

Vjosa Statovci 13v





PSE EKZISTOJ?!

Qëllim final apo ideal jetësor?

Nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër veçse të më adhurojnë" (Edh - Dharijat; 56)

Efillova këtë ese me një fjalë të Krijuesit të madhërishëm, me një fjalë e cila rrumbullakon qëllimin e qëllimeve. Kjo fjalë është e madhe aq shumë, sa qe e mban botën të gjallë. Më mban frymën e njeriut brenda tij dhe stabilizon çdo ekzistencë në këtë botë.

Kaluan gjenerata e gjenerata e vazhdojnë të jenë edhe sot, që ende nuk dinë qëllimin e ekzistencës së tyre, qëllimin e ardhjes në këtë botë. Vijnë në jetë si të vegjël, rriten e plaken pa e ditur se për çfarë arsye janë krijuar. Sa ide të çmendura kanë ata njerëz pa qellim jetësor, si sillen vërdalle si të humbur, vrapojnë pas kënaqësive të dunjasë, por edhe kur ndalojnë vrapin e kuptojnë që ishte vetëm kënaqësi e përkohshme. E trupin e mendjen e tyre e hutojnë për një kohë të shkurtër, ndërsa shpirti ngarkohet e mbushet me mëkate e ligësi, saqë zemra ngurtësohet e nuk pranon kurrsesi shkëlqimin e margaritarëve të imanit.

O Zoti im si nuk e kuptojnë ata, ndërsa marrin oksigjen për çdo sekondë. Si nuk e kuptojnë qëllimin e shijimit të bukurisë së dynjasë ?! Si të i tregoj atyre se jetojnë vetëm se Ti deshe që ashtu të jetë jeta jonë?

Të adhuroj Ty o Mëshirues I Plotfuqishëm është qëllimi I çdo hapi që bëj. Është arsyeja e çdo përpjekjeje time si krijesë e dobët pranë Madhërisë Sate.

Pra çdoherë që rrëzohem, dëshpërohem, e hidhërohem nga hallet e kësaj jete, ngritëm përsëri, por jo që të hakmerrem, por që prapë të vë ballin tim në tokë, të bie në sexhde Ty o Mirëbërës I të gjitha mirësive.

Po të mundja do të i jepja të gjithëve sytë e mi të shikojnë dhuntitë e të mirat që na I dha, e që edhe me kalkulatorin më të përsosur nuk mund të i numërojmë.

Atëherë ata do të jenë në gjendje të kuptojnë se para të qenurit idealist i diturisë, pasurisë, famës e gjërave të tjera, duhet së pari të jesh adhurues I Krijuesit.

Hyrishahe Morina 13v

Do të bindeni dikur...

Errësirë qe ka kapluar çdo gjë. Mendoj që ka kapluar edhe zemrën time në këtë moment. Meqë gjate kohës sa isha pranë jush nuk arrita ta bëja atë që zemra ime dëshironte, shpresoj që nga tani e tutje do të bindeni!

Asgjë nga kjo jetë nuk do të doja vetëm të ju shihja të udhëzuar ashtu siç shihja të tjerët. Dilja jashtë dhe shikoja përreth këtë univers kërkoja përgjigje nga gjithandej, askush nuk me fliste!Mundohesha në çdo aspekt të ju flisja e të ju fusja ne zemër atë që unë dëshiroja, por nuk arrita deri më tani, e sot kam mbetur e shtrirë mbi këtë shtrat në mes të katër mureve dhe pres të me vijë një mysafir e të më marr këtë shpirt të lodhur që me ka mbetë.

Këtë fuqi sa kam tani nuk dua ta kaloj me lot. Jo! Në asnjë mënyrë, dua ta shpejtoj lapsin të shkruaj, të shkruaj këto fjalë të fundit ndoshta, e ndoshta këto do të jenë dritë për udhëzimin e juaj! Me te vërtetë se do te bindeni dikur, mirëpo unë deri ne këtë moment nuk ndjeva kënaqësi në shpirt për udhëzimin e juaj.

Shumë herë në jete qava për mosudhëzimin e juaj dhe tani nuk kam fuqi të flas më.

Nëse nuk me dëgjuat dje, nesër do te keni mall të më dëgjoni, nëse nuk dëshiruat të më shihnit dje, nesër do te keni mall të me shihni.

Kam frike ...Kam frike të vdes.

Kam frike të jetoj, se nga unë do të dëshpëroheni.

Kam frikë të flas, se nuk do të me dëgjoni.

Kam frike të hesht, se do të më harroni.

Një porosi të fundit kam për ju: Kur te udhëzoheni ndonjëherë, mua më kujtoni.

Edhe pse nuk më patë duke qare mund ta param-endoni.


Ndoshta dikur do te me kërkoni


Të më kërkoni falje e të më falënderoni.

Në këtë moment të fundit ende kam shpresë.

Se sa ta kem këtë shpirt gjallë them: shpresa e fundit vdes.

Anita Gerguri 10v





Jeta

Sot vendosa të shkruaj pak për jetën. Siç dihet jeta për çdo njëri është diamant i çmuar, por mund të jetë edhe lojë. Sekreti i jetës qëndron në atë, se a di ta luash atë lojë?!



Jeta është një sfidë e madhe ku vazhdimisht na sfidon dhe i matë fuqitë tona.

Jeta është e shtrenjtë, por edhe e shkurtë. Çdo njëri e di se jeta është një ëndërr ku një ditë do të zgjohesh dhe do të përfundosh, andaj mundohu që këtë ëndërr ta bësh sa më të bukur. Ja që mua kjo copë letër nuk do të më mjaftojë të shkruaj rreth jetës. Ashtu-kështu kalojnë ditët, muajt, vitet, ku njeriu më shumë e kupton vlerën e jetës.

Në fillim pothuajse nuk dinim asgjë. Më vonë jeta na dha dhuratën më të bukur, shqiptimin e fjalës: "Nënë", më pastaj mësuam të shkruajmë, të lexojmë ë shumëçka tjetër. Burimi i vetëm i kësaj jete është dituria. Pra, në jetë ekzistojnë disa gjëra shumë të mira, të cilat na bëjnë shumë të lumtur, por edhe shumë të pikëlluar.

Nganjëherë valët ë jetës na godasin thellë në zëmrat tona, nganjëherë stuhitë ë kësaj jete na turbullojnë mendjet tona. Nganjëherë jeta na rrëmben nga më të dashurit tanë. Vitet shkojnë dhe fillojnë të thahen posi fletët ë trëndafilit nën shiun dhe freskinë ë stinës së vjeshtës.

Jeta është si një tortë, ku secili nga ne duhet ta provojmë shijen e sajë edhe pse çdo njëri nga ne dëshiron pjesën më të ëmbël ta ndajë për vete. Ne lindëm që të jetojmë dhe jetojmë që të vdesim. Humbjet tona janë pjesë ë jetës, të cilat na sjellin momentet më të vështira. Fitoret janë momentet më të mira, që na sjellin gëzim, hare dhe buzëqeshja jonë e ëmbël shoqëron fytyrat tona.

Pra, mos harro që jeta është një mrekulli, të cilën s'mund ta shijosh sa herë që ti dëshiron!

Hatixhe Ramadani 10v



Thjesht "Pse Jo"

Në momentin kur gjithçka errësohet, kur koka turbullohet dhe mëndja venitet mendoj "Pse unë". Pse unë duhet të bëj diçka ndryshe?! Pse unë ia caktoj vetës një mision të tillë?! Pse nuk bëj një jetë të thjeshtë e të lehtë si shumë të tjerë ?!

Vazhdoj të mendoj nga rraskapitja gjëra që më duken të arsyeshme. Por aty për aty them: "pse jo"?! Pse të mos bëj diçka ndryshe?! Pse të mos kem qëllim në jetë?! Pse duhet të jetoj si të tjerët?!

Besoj që thelbi i çdo suksesi është durimi dhe nuk lëkundëm asnjëherë. Por të jesh i qëndrueshëm në mesin e atyre që u janë dorëzuar lehtësisë e përtacisë, kërkon durim të gjatë e të vazhdueshëm.

Të flasësh për synimet e tua para njerëzve që nuk kuptojnë e që kot jetojnë është qesharake. Të jetosh në mesin e atyre ku nuk mund të shprehësh, është ngufatje. Kështu ndodh te ne. Qeshin kur thua se do të arrish diçka. Por ne do ta bëjmë e këtë do ta dëshmoj koha.

Kur lodhesh pusho, e kurrë mos thuaj "pse unë" por thuaj "pse jo".

Kur ndien se jeta po të ndrydh më vështirësitë e saja, kurrë mos u dorëzo. Kur ndien se je lodhur duke vrapuar pas kohës që ikën si e marrë, kurrë mos ndalo. Se jeta është kjo e nga ajo gjë, tjetër mos kërko. Thjeshtë Kujto:

"E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqertë". (3:139.)

Merjeme Kqiku 12v

Vetëm Atë e madhërojë



Allahu që më krijoj
kujdeset për mua

Kur unë veproj mirë

Ai ndaj meje ka mëshirë
Allahu më krijoj


tek Ai do të shkoj
për mundin që jap

shpërblime do të fitoj
Allahu më dha jetën

ma dha edhe shëndetin
nëse e meritoj

ma jep edhe Xhennetin.

Xheneta Dushullovci 11v



"Jetojmë"

Jetojmë dhe vdesim

Lundrojmë por nganjëherë edhe mbesim.

Disa jetojmë në ëndrra e disa në realitet.

Kur veprojmë më kokën tonë,

kur asnjë këshillë nuk e dëgjojmë.

Ne lindim për të jetuar

Jetojmë për të vdekur

Dhe vdesim për të jetuar

Andaj le të kemi kujdes

Në rrugën të cilën jemi duke shkuar.

Albulena Jaha 12 v

Pa gjysmën e shpirtit tim



Errësirë në sheshin e vetmisë. Dua të mashtroj vetveten, të vë në gjumë mallin e dhimbjen, por nuk mi merr gjumi amanetet.

Si jetim në dynja kam mbet. Me shikimin drejt qiellit të mrrolur,pres ndriçimin e hënës.
Së paku ajo të më qëndroj pranë e të rrëfehem me të.

Ti them së dua të prek ëmbëlsinë e buzëqeshjes së dikujt. Ta kem në mendimet e natës së vonshme. Me germa fjalësh ta pikturoj dashurinë që kam për te.

Baba të thërras nga toka. Këtu ka vogëlushë dhe shtatore, këtu ku në mendje ka ëndrra që jetojnë "Jetë në ikje".

Baba amanet kërko nga Zoti të të jetësojë vetëm për një çast që të njoh, të shoh.

Kthehu të pret ndjenja ime. T'i prek rrudhat në ballë e thinjat në kokë, se kështu të skaliti nëna tek unë " Iu thinj flokët, e u plake për një natë me merakun për ty. E dinte se do të vdiste, të vdiste si hero ama".

Sa do të doja të therja kohën më thikë të mprehtë, që kujtimet të më ktheheshin atëherë ku lëvizja lirshëm në barkun e nënës pa menduar se në këtë botë do vija pa gjysmën e qenies time. Ti ike. U trete e unë mbeta gjysmë në shpirt.

Në këtë natë më erdhën ca ofshama, që kurrë si pata dëgjuar, amanete ishin.

Sonte me mungesën e shpirtit dua t'i arsyetoj ndjenjat.

Ti këndoj ninullat e moteve, të pikturoj mërzinë me brushat e dhimbjes. Mbi te të shkruaj më bojë pa ngjyrë, se ngjyrë kam lotin.

T'i them se, edhe sikur kozmosi të merrte përmasat minore në peshoren e shpirtit, s'do të peshonte në peshoren e shpirtit sa mungesa e të atit për vuajtjet e nënës.

Po flas fjalët e fundit se fuqinë ma morën lotët. S'mundëm as të shkruaj, se duart m'u shtangën.

Dua thjesht të dëgjoj tingujt e melankolisë së natës e të mbytëm në gjumë si e vdekur nga ofshamat e pa thëna të nënës.

Dua së paku që ëndrrat të më bëjnë të lumtur.

Të kuptoj së në këtë botë është një vajzë e vogël.

Vogëlushja jote që nuk e beson kurrë së ti nuk jeton më.

Shpresojë se ty të morën engjëjt lart në parajsë se ti ishe engjëlli im babi.

Fjalët s'mi thotë goja, por zëmra mi thur "Baba ty të njohë, të njoh tek e kuqja në flamur"

Majlinda Rexhepi 11v

VATËR DITURIE



Në një pjesë të qytetit
dukë kaluar e gëzuar
një objekt i madh
më kishte befasuar.

Më gëzim të madh
pranë saj u ofrova
më zëmër plotë ë më shumë gëzim
Alaud-din shqiptova.

Në kokën time të hutuar
një gjë s'mund të kuptoj,
nëse jam në realitet
apo thjesht po ëndërroj.

Në këtë vatër të diturisë
që sot e gëzuar mësoj
e ëndërrova dje
dhe ja, sot po e përjetoj.

Do t'a nxjerr hakun
sepse vet e kërkova
Alaud-din në zëmër
shumë herët shënova.

Kam shumë për të thënë
por më kaq po e përfundoj
e falënderoj Allahun e Madhëruar
që këtë gjë ma mundësoj.

Anita Gërguri 10/v

DO TA KUPTOSH

Kur të ketë kaluar kohë nga agimi
Dhe rrugëton larg së kotës
Do ta kuptosh së bota nuk sillet rreth teje
Por ti sillesh rreth botës


Kur të ndalësh tek dritarja
Dhe larg në qiell vështron
Do ta kuptosh së lartësia nuk është jeta
Edhe në tokë jeta vazhdon

Po ç'të bën ty të ndalësh hapin?!
Kur rrugën e ke të shtruar
E edhe do ta duash goditjen që rrëzon
Se të kujton se ke gabuar

Kur kokën lart mban
S'arrin këmbët e tua të shikosh
Ç'faj ka milingona që e shkel
Ç'të bën të tjerët të harrosh

Kur dëshiron të mos shohësh
Atë çka pranë syve ke
Ajo që është bërë nuk zhbëhet
Andaj kokën nga drita me kohë ktheje.

Jehonë Sylejmani / 11v



DUA MË SHUMË SE GJITHÇKA

Ka kohë që kam menduar të të shkruaj, por gjithnjë lotët më pengojnë, kështu që kësaj radhë vendosa të të shkruaj diçka ndryshe, edhe pse e di që kjo letër s'do arrij dot tek ti.

Dua të të shkruaj diçka të bukur kësaj radhë. Por, si të të shkruaj diçka të bukur kur lotët menjëherë behën pjesë e fjalëve të mia.

Thuhet se ku ka dashuri ka edhe dhimbje. Kështu që nuk do e quaj më "mall" ndjenjën që përjetoj sa herë që të përmend ty, por do ta quaj "dashuri". Vite kanë kaluar qysh se ti je larguar, por me ty nuk u largua edhe dashuria që pata për ty. Përkundrazi ajo u rrit e u rrit, vazhdimisht.

Sa i paaftë që është lapsi përkundër aftësisë së zëmrës për të të dashur përherë e më shumë. Sa e vogël më duket kjo letër, përkundër dashurisë që ka zënë vend në zemrën time.

Kam aq shumë gjëra për të të thënë. Por ku t'i shkruaj?! Ku ti shkruaj, kur e di që ti nuk i lexon dot. Kam aq shumë gjëra për të të treguar saqë as netët kur rrinim zgjuar deri në orët e vona, s'do të na mjaftonin.

Kam aq shumë dilema para vetës, por kështillën tënde s'do e marr dot kësaj radhe. Pikërisht tash kur më duhesh më shumë së kurrë, ti nuk je më. Pikërisht tash kur më nevojitet ndihma jote të vendos së çfarë të bëj më tutje, ti nuk je. Sa qartë më kujtohen fjalët e tua të ëmbla, edhe pse ka kohë që nuk e kam dëgjuar zërin tënd.

Nganjëherë zgjohem natën, më duket sikur dëgjoj zërin tënd. E çështë më e keqja prapë më duhet të fle, ngase e kuptoj se ajo nuk ishte asgjë më shumë së një ëndërr, si shumë të tjera. Sa bukur do të ndjehesha të ishte vërtetë zëri yt. Por, kjo nuk realizohet dot. E pas kësaj kam një dëshirë tjetër. Dua patjetër të kthehem në ëndërr, por nuk mundëm dot, diçka nuk më lejon.

O Zot, sa e vështirë!

Dua që të paktën në ëndërr të çmallem. Ndjej shumë mall... Ndjej aq shumë mall saqë ëndrra më duket ngushëllimi më i mirë që do të mund të merrja. Si çdo natë tjetër i lutëm Zotit të të shohë në ëndërr, por jo. Zgjohem e dëshpëruar në mëngjes. Çdo mëngjes them më vete: sikur të flija vetëm edhe pak, ndoshta këtë herë do ta shihja në ëndërr.

Sa e vështirë qenka të kërkosh diçka të paarritshme.

Sa herë që dëgjoj derën teksa hapet, më kujdes dëgjoj hapat e i them vetes: ah sikur të ishin hapat e tu. Shpeshherë më kujtohet kur ulesha pranë teje. Lehtas lëmoje kokën time dhe më tregoje për fëmijërinë tënde. U rrite jetim pa baba. Nganjëherë edhe qaje. Tani edhe unë po qaj. Nuk po qaj për fëmijërinë tënde, jo! Po qaj ngase edhe unë po përjetoj të njëjtat që ti përjetove. Edhe unë po rritem jetim pa baba. Po rritëm në mënyrën që ti më së paku e dëshiroje, jo që nuk dëshiroja që ti të vdisje, por nuk dëshiroja që ne të përjetonim ato që ti përjetove.

E sheh, asnjëherë nuk mundem të arrijë qëllimin tim. Nuk po arrij asnjëherë të përfundoj një letër që të shkruaj për ty pa qarë.

Lotët vazhdimisht vërshojnë fytyrën time.

Do të doja të të tregoja edhe diçka tjetër. E di?! Nganjëherë më thonë se të kam ngjarë me disa tipare, zemra më bëhet mal nga gëzimi.

Ti gjithmonë ishe ideali im.

Ishe dhe do të mbetesh përherë i paharruar, babai im. Ashtu dikur thosha: BABI më i mirë në botë.

Albulena Hajraj 13/v

RRUGËTIMI NË TURQI

Sa shumë e ëndërruam, sa shumë e pritem e sa shumë e dëshiruam.

Ishte ëndrra e kamotshme. Ishte dëshira jonë e zjarrtë që një ditë të shkonim atje. Ishte tetori i ngrohte për ne, që këtë ëndërr e bëri realitet.

Ditët assesi të kalonin e të vinte dita për t'u nisur. Në aeroport u bashkuam më homologët tona të paralelë së ndarë fizikë në Prizren.

Me të arritur në Stamboll, gjithçka dukej edhe me e bukur, madje duket se edhe dielli filloi te lëshojë rreze të ngrohta mbi fytyrat e qeshura të maturantëve.

Në pritje kishte dalë autobusi e siguruar nga komuna e Pendik-ut (Pendik belediyesi), si dhe shoqëruesi ynë Metin Tavukcoglu, që na shoqëroi gjatë tërë qëndrimit tonë atje, që kurrë nuk hezitoi t'i plotësoj kërkesat tona.

Prej aeroportit vazhduam për në konviktin e kursit të Kur'anit (Bahceli Evler Derya Kiz Kur'an Kursu-Uskudar), që njëkohësisht ishte edhe vendqëndrimi ynë gjatë qëndrimit tonë në Stamboll.

Të nesërmen u nisem për në Bursa, qytet ky i banuar më shumë shqiptar. Vendi i parë që vizituam atje, ishte xhamia e madhe Ulucami. Ishte diçka shumë e bukur dhe mahnitëse për ne. Një arkitekturë aq e bukur, dukej që ishte bërë një punë e palodhshme, për ta sjellë xhaminë në atë pamje marramendëse. Ishte ajo xhami më historikun e lashtë që bartë më vete, që na la mbresa shumë. E që edhe sot e ëndërrojmë një xhami të tillë për vendin tonë.

Atë ditë patëm fatin të ishim mysafir të kryetarit të Bursas, Rexhep Altepe. Pas shumë vizitave tjera që bëmë atë ditë, atë natë qëndruam në një konvikt, ku u takuam dhe u njoftuam më shuma studentë turq, u njohëm më botën studentore të turqve.

Rrjedha e vizitës sonë vazhdoi për në Çanakala. Atje pamë diç që na emocionoi shumë dhe preku ndjenjat tona fetare, vizituam varrezat e shumë shehidëve, mes tyre edhë shqiptarë. Ditët tjera qëndruam në Stamboll. Vizituam shkolla, komuna, muze, pallate... Të gjitha këto zinin vend në kujtesën tonë, dhe shënoheshin në librin e kujtimeve më të bukura, sidomos të jetës shkollore. Gjithçka ishte e bukur, por fakti se ishim me shoqëri sikur i jepte magji gjithë asaj. Kush e di se a do të mund t'i vizitojmë serish ato vende?!



Çdo vend që vizitonim ishte më i bukur se tjetri.

Pastaj mikpritja që na e bënë, na la pa mend. Na respektonin aq shumë, sikur ne të ishim prijësët e shtetit tonë, e jo thjesht nxënëse të shkollës së mesme. Apo ndoshta kishin të drejtë, ne jemi ardhmëria e vendit tonë.

Shume kryetare të komunave të Stambollit, drejtorë të shkollave, prijës fetarë na shoqëruan pa kursyer asgjë.

Prej vendeve më te bukura që vizituam ishin xhamitë, si ajo Suleymaniye, xhamia e Ejub-Ensariut, e shumënjohura xhamia me gjashtë minare, xhamia Sulltan Ahmet, Muzeu Panorama, parku "Turqia në miniaturë", pastaj udhëtimi me anije përreth Bosforit.

Me 14.10.2011 përfundoi vizita jonënjë javore në Turqi. Pas shumë e shumë vizitave, momenteve të paharruara, na u desh që sërish të ktheheshim për të vazhduar rrugën aty ku kishim mbetur. Padyshim që do të jetë experiencë e paharruar për ne si maturante.

Assesi s'do ta harrojmë pa falenderuar ata që na e mundësuan këtë ekskursion.

Albulena Hajraj 13/v

SHQIPTARËT DHE VENDET E SHENJTA

1.MEKË MEDINE

Shqiptarët në vendet e shenjta u paraqiten shumë herët, qysh në shek.XV-XVII për haxhillëk, kurse me vonë paraqitja e tyre merr formë tjeter e sidomos në shek.XIX e në fillim të shekullit XX.

Në mesin e shek. XVI në Mekë e Medine e gjejmë arkitektin shqiptar Mimar Sinani. Ai qendroi disa vite në këto vende për të ndërtuar një sërë objektesh fetare shoqrore-arsimore, nga libri "Permbledhja e objekteve" që perfshin më se 400 objekte nga arkitekti shqiptar por njëherit gjejmë edhe gjashtë objekte në Mekë e Medinë:

*Një xhami ne Mekë.

*Një medrese ne Mekë.


*Një dar al-kurra (shkollë per mësimin e Kur'anit) në Mekë.

*Një vendpushim për kuaj me një pus uji në Mekë.

*Një imaret (kuzhin popullore) në Mekë dhe

*Një imaret në Medine.

Po ashtu valiu(mëkëmbësi) shqiptarë i Jemenit Sinan Pasha 1569-1571 në këto vende ndërton objekte të reja, gjatë haxhillëkut të tij në pranverë të vitit 1571 siq tregon edhe historiani i njohur jemenas al-Makki i cili e shoqerojë Sinan Pashën, e që më vonë shkroi një libër voluminoz për të, ku në këtë libër kemi të dhëna të vlefshme per objektet që kishte ndërtuar Sinan Pasha. Prej veprave të tij,



Sinan pasha më së shumti lavdërohet për furnizimin e Mekës me ujë të pijshëm që të freskoheshin vizitorët e saj. Për këtë ai kishte ndërtuar një kanal te gjatë që sillte ujë në qendër të Mekës.

Po ashtu,ai ndërtoi disa puse në afërsi të Medines që të furnizoheshin karavanet me ujë.

Shqiptarët vendet e shenjta i vizitonin në masë të madhe për haxh [peligrinazh] gjë që tani më e kishin obligim ata të cilët kishin mundësi dhe që kishin pranuar islamin sigurisht, rruga për në haxh ishte shumë e vështirë dhe zgjaste së paku 10 muaj apo 8 muaj sipas burimeve osmane*5

Në atë kohë Damasku ishte qendër e tubimit të shqiptarëve.Rruga nga Damasku e deri në Mekë zgjaste 2 muaj udhëtim me deve. Damasku për shqiptarët jo vetëm që ishte vendpushim gjatë rrugës për në haxh, por ishte dhe një kryeqendër më shumë valinjë shqiptarë si Lala Mustafa pasha 1563-1569, Sinan pasha1589-1590,Mustafa pasha i biri i vezirit [kryeministrit] të madh Ajas pasha, Mehmet pasha, Nasuh pasha 1600-1606 e më 1611 u bë vezir i madh, pastaj me 1606 prap një vali shqiptarë Kuçuk Sinan pasha, ky ndërtoj Xhamin në Prizren që mban emrin e tij [Xhamija e Sinan pashes],

Pastaj Mehmet pasha Kopryly edhe ky më von u bë vezir i madh , Ahmet pasha 1660-1661 e më pas vezir i madh për 15 vjet që ishte perjudh më kulminante në P.Osmane etj.

Posti i "sadriazemit"-kryeministrit- në administratën osmane, është konsideruar nga postet më të larta shtetërore, menjeherë pas postit të sulltanit. Postin e sadriazemit e kanë pasur një numër i madh i shqiptarëve. Gjatë sundimit osman në ballkan, 42 shqiptarë kanë arritur postin e sadriazemit.*6

1. Raporti i konsulit anglez ne Kajro drejtuar Ministritë Anglez të pumve te Jashtme më 5 VI. 1815, ibid, faq1-11

2. Dr, Muahamed Mufakut "Shqiptarët në botën arabe"(Shek. XVIII- fillimi i shek.XX) Prishtinë


3. forumishqiptar.com tema HISTORIKU I HAXHXHIT NDËR SHQIPTARËT

4. Dr, Muahamed Mufakut "Shqiptarët në botën arabe"(Shek. XVIII- fillimi i shek.XX) Prishtinë

5. Islam (Hagj), "Edukata Islame",nr.15-16.Prishtinë 1976 faq.12.

6. M.R Samir B. Ahmeti "ROLI I OSMANLINJEVE NE PERHAPJEN E FESE ISLAME NE KOSOVË 792-906h/ 1389-1500m, Prishtinë 2010, faq: 167..

Nexhmi Syla XIII



"BUZËQESH TI, TË GËZOHEMI NE"

ISHTE MOTOJA JONË PËR KËTË AKTIVITET



Për të treguar dashurinë dhe vëllazërinë tonë edhe me personat jashtë Medresesë, morëm iniciativë që në prag të festës së Kurban Bajramit më 04.11.2011 të përgatisim një program modest brenda mureve të Medresesë.

Për t'ia rritur vlerën këtij programi, prezent ishin edhe mediat, të cilat punën tonë e bënë të njohur edhe për të tjerët.

Atë ditë nxënësit bashkë me profesorët dhe me mbështetjen e drejtorisë së shkollës dhanë më të mirën nga vetja e tyre,vetëm e vetëm që të ftuarit të ndjehen të gëzuar.

Si çdo program edhe ky u hap me fjalën e Alllahut xh.sh. kënduar nga nxënësi i vitit të III-të, Egzon Ibrahimi.

Më pas fjalën e mori drejtori i Medresesë Bahri ef.Simnica, i cili asnjëherë nuk hezitoi që të na përkrahë në idetë dhe iniciativat tona. Gjithashtu, ai me ngrohtësi u uroi mirëseardhje njëqind fëmijëve jetimë që ishin të ftuar në programin tonë.

Për të vazhduar programin më tutje fjalën e mori edhe kryetari i shoqatës së nxënësve të Medresesë Liridon Zhegrova, ku në emër të nxënësve të Medresesë falënderoi të gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij programi, qoftë moralisht apo materialisht.

Pas përshëndetjeve programi u pasurua me filmin e animuar si dhe me sloganin "Buzeqesh ti, të gëzohemi ne" ku për secilën shkronjë vajzat na e thanë nga një fjali të artë.

Pas gjithë këtyre, pjesa që u pëlqeu tej mase fëmijëve, ishte skeçi i përgatitur nga nxënësit e Medresesë, të cilët me rolin e tyre si palaço i bënin fëmijët të qeshnin.

Dhe pas te qeshurave, në skenë aktori Basri Lushtaku interpretoi shkëlqyeshëm vargje nga monologu "I dashuri vëlla", i cili tek ne ngjalli ndjenja mallëngjyese.

Pastaj erdhi pjesa më e bukur e këtij programi, ku secilit fëmijë iu dha nga një dhuratë, që fëmijët të ndjeheshin më mirë dhe më të lirë. I ftuam që pas marrjes së dhuratave të qëndrojnë në skenë dhe bashkë me korin e vajzave të këndojnë ilahi. Për ta begatuar programin u shtrua drekë për të gjithë pjesëmarrësit.

Dhe në fund të gjithë fëmijëve të ftuar iu dhurua nga një pako ushqimore.

Ky ishte aktiviteti i dytë nga Medreseja qe u be për fëmijët jetim.

Shpresojmë që kjo traditë te vazhdojë dhe të mos ketë të ndalur.

Fatlume Çitaku 12v



Të jetoj për ty është qëllimi im

Sa të vogël e ndjej veten karshi Madhështisë Tënde
Sa të dobët e ndjej veten karshi Fuqisë Tënde
Sa shumë të meta që shoh te vetja karshi Përsosmërisë Tënde
Por sa të sigurt e ndjej veten me dinin Tënd
Sa e mbrojtur e ndjej veten kur mbështetem tek Ti.
Ti je Ai që më krijove.
Ti je Ai që më dhurove çdo gjë që kam.
Ti ma fale nënën e me të më mëshirove
Ti je Ai që ma dhe babanë e prapë ma more, e me këtë më sprovove
Ti je Ai që më dhe vëllezërit e me ta më sigurove.
Ti je Ai që më dhe mendjen e më begatove
Ti je Ai që me dhe udhëzimin e me të më shpëtove
Te jetoj me shpresë e në Ty të kem besim
Të jetoj për Ty është qëllimi im.

Albulena Hajraj 13/v

KURIOZITETE

- Lopët mund të ngjiten në shkallë, por jo të zbresin.
- Një gjarpër mund të bie në gjumë për një periudhë tri vjeçare.
- Fluturimi me i gjatë i një zogu pule është regjistruar 13 sekonda.
- Milingonat nuk flenë.
- Një urith mund te gërmoje një tunel 90 metra të gjate brenda një nate.
- Kuajt mund te qëndrojnë deri ne një muaj në këmbë.
- Një lopë gjatë jetës së saj mund të jap 200.000 gota qumësht.
- Në trurin e maceve ka 32 muskuj.
- Çdo vit numri i makinave shtohet 3 herë më shume se i njerëzve.
- Flokët dhe thonjtë vazhdojnë të rriten edhe pse njeriu të ketë vdekur.
- Në qytetin e Hamburgut në Gjermani ka 27 xhamia.
- Nervi optik i syrit përbehet prej 500 mijë fijesh, të cilat nëse renditen njëra pas tjetrës do te arrijnë gjatësinë 60 kilometra.
- Mendohet se nga krijimi i shoqërisë njerëzore në botë kanë jetuar mbi 80 milion njerëz.
- Çdo ditë në botë lindin 250.000 njerëz. Në çdo 100 vajza të sapolindura korrespondojnë 105 djem të sapolindur.
- Thaumatoccocus danielli është 61.500 herë më e ëmbël se sheqeri i zakonshëm. Kjo bimë rritet në disa vende të Afrikës perëndimore.
- Arusha e bardhë mund të notojë pa ndërprerë deri 100 km.
- Kafepirësit mendojnë me shpejte dhe veprojnë më logjikisht se ata qe nuk e përdorin kafenë.

Përgatitën:
Esra Hashani,
Vesel Sylejmani 11a,
Alie Segashi 13v,
Liridon Zhegrova 13

DELEGACION I LARTË I MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE VIZITOI MEDRESENË



Një delegacion i lart saudit vizitoi Kosovën, e ndër t tjerash vizitoi edhe shkollën tonë.

Këtij delegacioni i printe z. Abdulaziz Alamar, zëvendësministër për çështje fetare e vakëfe i Mbretërisë së Arabisë Saudite i shoqëruar me bashkëpunëtor. Pjesë e këtij delegacioni ishte edhe ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë z. Abdullah Abdulkerim. Delegacionin e shoqëronte Myftiu i Republikës së Kosoves z. Mr. Naim Tërnava me bashkëpunëtorë.


Ata u pritën me shumë respekt nga drejtori i shkollës Prof. Bahri ef. Simnica. Pasi që u njoftuan nga drejtori i shkollës me historikun e medresesë, punën e saj, rolin dhe rendësin që ka ajo në vendin tonë. Ata nuk lanë pa u takuar edhe me nxënësit e Medresesë.

Ata vizituan nxënësit për gjate një ore mësimore. Edhe kjo vizite, si edhe gjithë vizitat tjera, që bëhen në shkollën tonë, janë te mirëseardhura si nga stafi i shkollës ashtu edhe nga vetë nxënësit.

Albulena Hajraj 13v



VIZITA E REFERENTIT PËR POLITIKË, KULTURË DHE SHTYP NË AMBASADËN E GJERMANISË



Si gjithmonë në shkollën tonë asnjëherë nuk mungojnë vizitat nga zyrtarë të ndryshëm si të vendit ashtu edhe nga vendet tjera.

Më 11.11.2011 z.Christoph Deißenberger, referent për politike, kulturë dhe shtyp në ambasadën e Gjermanisë, vizitoi Medresenë.

Ai u takua me drejtorin Bahri ef. Simnicën, i cili e njoftoi për Medresenë, statusin e saj, lëndët mësimore dhe kurrikulat me të cilat punohet. Pas kësaj ai prezantoi në një orë mësimi. Përkatësisht në orën e gjuhës arabe, me profesorin e lëndës Fadil Hasanin, ku pas kësaj nxënëset patën rastin të njihen më shumë me sistemin e shkollimit në Gjermani, nëpërmjet ligjëratës që mbajti në klasë.

Pastaj foli edhe për mësimin e fesë në Gjermani, për të cilën tha që është e vetmja lëndë obliguese e përmendur në kushtetutë.

Foli rreth asaj se a lejohet bartja e shamisë nëpër shkollat e vendit. Për dallim nga vendi ynë ai tha që në shumicën e shkollave lejohet bartja e obligimit fetar të myslimaneve, përkatësisht shamia. Ajo që diskutohet është se a lejohet që mësimdhënësja të jetë me shami.

Në fund të ligjëratës z.Deißenberger shpjegoi dhe ndau broshura me informata rreth bursave për të studijuar në Gjermani. Me këtë rast bibliotekës së shkollës i dhuroi disa libra rreth Gjermanisë.

Ne si nxënëse të Medresesë e falënderuam z.Deißenberger për kohën që ndau për ne, me shpresë që vizita të tilla aq produktive do të ketë edhe në të ardhmen.

Kjo vizitë u realizua në bashkëpunim me Kryesinë e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, të cilën e falënderojmë për këtë bashkëpunim.

Albulena Hajraj 13v

DUKURITË NEGATIVE NË SHOQËRI

"Dukuritë negative në shoqëri", ishte tema e cila u ligjërua nga profesoresha Ajete Haxhiu me 08.12.2011 në shkollën tonë.


Gjatë ligjëratës së saj, ajo shtjelloi problemet e shumta të cilat janë përhapur në masë të madhe në mesin e shoqërisë sonë si: duhani, droga, alkooli dhe prostitucioni.

Ligjërata ishte e pasuruar edhe me slajde të përgatitura nga profesoresha, që t'u ndihmonte të pranishmeve të fokusoheshin edhe më tepër në temë.

Pjesmarrëse në këtë ligjeratë ishin profesoreshat dhe nxënëset e Medresesë Alauddin.

Shpresojë që sado pak të ketë lënë gjurmë tek ne, dhe lus All-llahun Fuqiplotë që të mos u afrohemi kurrnjëherë këtyre veprave të ndyta të shejtanit, e lëre më t'i praktikojmë.

Fatlume Qitaku 12v



TURNEU I FUTBOLLIT

Ndër aktivitetet që u zhvilluan në shkollën tonë ishte edhe turneu i futbollit 2011-2012.

Në garë morën pjesë gjithsej 12 ekipe nga të gjitha klasat e shkollës tonë këtu në M. M. "ALAUD-DIN" në Prishtinë.

Në xhiron e parë të garave kualifikuese u arritën këto rezultate:

1. IV (ekipi i parë) : II-a (ekipi i parë) 7:2
2. I-a (ekipi i parë) : I-b (ekipi i dytë) 0:1
3. IV (ekipi i dytë) : III-a (ekipi i parë) 1:0
4. I-a (ekipi i dytë) : III-b (ekipi i parë) 0:1
5. II-b (ekipi i dytë) : IV (ekipi i tretë) 0:3
6. II-b (ekipi i parë) : I-b (ekipi i parë) 2:1.

Në xhiron e dytë u zhvillua një konkurrencë më e fortë, ku u luajten këto ndeshje:

1. IV (ekipi i parë) : I-b (ekipi i dytë) 3:2
2. IV (ekipi i dytë) : III-b (ekipi i parë) 3:0
3. IV (ekipi i tretë) : II-b (ekipi i parë) 4:3 pas ekzekutimit të penaltive

Në gjysmë finale u kualifikuan këto ekipe:

1. IV (ekipi i parë) : IV (ekipi i tretë) 2:3
2. IV (ekipi i dytë) shkoi në finale pa lojë.

Në praninë e shumë shikuesve dhe një atmosfere sportive u zhvillua finalja e këtij turneu, ku u ndeshën dy ekipet që patën suksese më të mira.

IV (ekipi i dytë) dhe IV (ekipi i tretë).

Fitues nga kjo ndeshje finaliste doli **ekipi i tretë i vitit të IV** me rezultat 1:2.

Ndërsa gjatë zhvillimit të këtyre ndeshjeve si golashënuesi më i mirë u zgjodh Admir Kadriu.

Admir Kadriu



Egzon Ibrahimi zë vendin e parë në *tertil*, në nivel evropian

Në garat e nivelit evropian ka qenë pjesëmarrëse edhe Medreseja e Mesme Alaud-din, të cilën e përfaqësuan nxënësit: Egzon Ibrahimi dhe Jaser Krasniqi.

Nxënësi, Egzon Ibrahimi pas publikimit të rezultatëve nga komisioni i garave zë vendin e parë në lexim "tertil" në nivel të medreseve. Nxënesi në fjalë iu dhurua diplomë (mirënjhohje) dhe një shperblim.

Po ashtu, medreses së mesme Alauddin iu nda një mirenjohje për pjesëmarrje me nxënës në këto gara kuranore.

Garat perfunduan me një ceremoni të madhe gjatë së ciloës u interpretuar lexim i bukur i Ku'anit,këndim të ilahive, dhe pjesë të mevludit në disa gjuhë. Xhamia e Zagrebit ishte e vogël për të akomoduar të gjithë muslimanet e interesuar që ia kishin mësyar kësaj xhamie, ku me dhjetra autobusa sillnin grupe nga viset e ndryshme të shtetit Kroat dhe nga Bosnja. Por edhe shumë bashkëatdhetar tanë shqiptarë nga Zvicrra, Sllovenia ishin present ne këtë eveniment.

Keto ishin garat e 18 të Kuranit në nivel Evropian të organizuar nga Bashkesia Islame e Kroacisë, Qendra Islame e Zagrebit dhe me Ministrinë e Vakfit të shtetit të Katarit.Garat ishin e organizuar në pesë nivele:

1. **Tertil në rangun e medreseve**
2. **Tertil i lirë**
3. **Hifz në 5 xhuza**
4. **Hifz në 15 xhuza**
5. **Hifz në tërë Kur'anin**



Vjen Bluetooth 3.0



Të dhënat e fundit mbi specifikat e standardit të ri zbulojnë se Bluetooth 3.0 do të mbështesë shpejtësitë e bartjes së dhënave sikur edhe Wi-Fi.


Bluetooth SIG para lansimit zyrtar ka publikuar detajet e standardit Bluetooth 3.0. Sipas informacioneve të fundit, nga paraardhësi i tij Bluetooth 2.0, standardi i ri do të jetë disa herë më i shpejtë

Sipas specifikave të paralajmëruara, versioni i tretë do të duhej të ofrojë shpejtësi të bartjes së dhënave sikur edhe Wi-Fi. Po ashtu, teknologjia e re Enhanced Poëer Control do të ndihmojë në ruajtjen e lidhjes edhe nëse pajisja gjatë bartjes së dhënave mbyllet, sa për shembull, nëse vendoset në xhep apo çantë.

Detajet shtesë do të publikohen më 21 prill, kur specifikat e këtij standardi do të publikohen edhe zyrtarisht. Se kur Bluetooth 3.0 do të mund të paraqitej në produktet e reja nuk dihet.



Më shpejtë se drita



Shkencëtaret pretendojnë se kanë matur një thërrmijë atomike më shpejtësi më të madhe se ajo e dritës.

Shkencëtaret kanë bërë një zbulim, i cili nëse vërtetohet, mund të ndryshojë ligjet e fizikes.

Një grup shkencëtaresh ndërkombëtar thonë se kanë matur një thërrmije nen-atomike, e quajtur neutrino, që lëviz më shpejt se shpejtësia e dritës – diçka kjo qe konsiderohej e pamundur.

Një përshpejtues (akselator) thërrmijash dërgoi një tufë neutrinosh në një largësi prej 730 kilometrash nga Qendra Evropiane për Kërkimet Bërthamore në Zvicër deri në një laborator ne Itali. Shkencëtarët thanë, se ata ishin shumë të habitur kur vunë re se neutrinot e kishin bërë këtë distancë brenda 60 nano-sekondash, pra më shpejt se shpejtësia e dritës.

Teoria e relativitetit e Albert Ajnshtajnit e vitit 1905 është një gur themeli për rregullat e fizikes dhe ajo bazohet mbi idenë se asgjë nuk lëviz me shpejt se drita.

Nëse ky zbulim mbi neutrinot vërtetohet, ai do të hedhë dyshime mbi shumicën e zbulimeve të bëra mbi mënyren se si funksionon universi.

Jusra Abdullahu 12/v

KOMPJUTERËT

LIROJNË GAZRA HELMUESE

Pluhri helmues qe gjindet ne procesore dhe ekrana kompjuterike permban substanca kimike qe janë të lidhura me çrregullime neurale dhe riprodhuese. Studimi i liruar nga Sillicon Valley Toxic Coalition, Computer TakeBack Caimpaign dhe Clean Production Action eshte i pari në këtë rrafsh....

Sfida më e madhe në ndërtimin e robotave të vegjel është miniaturizimi i furnizimit energjetik. Tani, hulumtuesit nga SHBA-ja, ndoshta e kanë zgjidhur problemin duke e eksploatuar levizjen natyrale të bakterieve për të "shtyrë" objekte nëpër ujë. Shumë bakterie shtyten nëpër langje duke u sillur rreth boshtit të vet, apo nëpër rruge të quajtura flagela. Këto flagela kanë diametër vetëm 20 nanometra, ndërsa janë të gjata rreth 10,000 nanometra.



Motorat e ndërtuar nga flagelat bakteriale janë përdorur edhe më parë në "nano motora mekanik", por Metin Sitti dhe Bahareh Behkam nga Carnegie Mellon University në Pennsylvania, SHBA, e kanë marrur një drejtim tjeter. Ata e përdorin të tërë mikroorganizmin sikur motor. Hulumtuesit filluan duke i ngjitur disa S. macrescens, lloj i bakteries që shkakton njolla ngjyrë pembe nëpër perde të tushit, në toptha të polistirenit me diameter 10 mikrona.

Këta "robota" të vegjel ishin të suspenduar në një solucion të përbërë nga uji dhe glukoza. Bakteriet kanë madhësi sa një e pesta e topthit dhe lidhen me atë përmes fuqisë elektrostatike, forcës van der Ëaals, dhe interakcioneve hidrofobike. Gjatë rrotullimit të bakterieve nëpër flangela, glukoza përrreth treted duke e shtyrë topthin përpara me shpejtësi prej 15 mikrona në sekondë. Përdorimi i tërë mikroorganizmit si motor ka përparësi, pohojnë hulumtuesit.

Bakteriet janë makina të mbështetshme të cilat mund të integrohen lehtë me komponente mikroskopike të cilat nuk duhen të pastrohen apo rindërtohen, sikur që është rasti me komponente të ndara bakteriale. Gjithashtu, motoret e bakterieve punojnë me ushqyes të thjeshtë sikur glukoza dhe janë të ndieshëm ndaj mjedisit të tyre. Kjo do të thotë se mund të kontrollohen me saktësi.


Sitti deklaron se "në të ardhmen, hibridet e tilla të mikro-robotëve do të përdoren për mbartjen e barërave brenda mjediseve të lëngëta në trup të njeriut, sikur trakti urinal, hapësira e syrit, vesh dhe lëngjet cerebrospinale". Ai shton se "ato do të mund të përdoren edhe për vëzhgimin e toksicitetit apo patogjenëve biokimik në mjedis, si dhe për vëzhgimin e gypave të mbushur me lëng në fluturake hapësinore apo prodhuese bërthamore të energjisë".

Përzgjodhi:
Ensar Halimi, XIII

Burimi i lajmit:
http://www.newscientisttech.com/article/dn11037-ba...

KAFSHËT
MË TË SHPEJTA NË BOTË


Nuk mund të krahasohet shpejtësia e të gjitha kafshëve, sepse varet nëse lëvizin në tokë, ujë apo ajër.



- Nëse do të ishte garë fluturimi në ajër (horizontalisht), "Spine-tailed Swift" do të fitonte, i cili shpend ka shpejtësinë 170 km/h.
- Nëse do të ishte garë vrapimi në tokë, gatopardi (cheetah) do të fitonte, shpejtësia e të cilit është 112 km/h.



- Nëse do të ishte garë noti në ujë, do të fitonte "Shortfin Mako Shark". Sipas Reef Quest Centre për studimin e peshkaqenëve, është matur saktësisht shpejtësia e tij, e cila është 50 km/h. Gjithashtu ka pohime që një peshkaqen i këtij lloji e ka arritur shpejtësinë 74 km/h.
- Peregrine Falcon (Skifterit shtegtues) vertikalisht është 321 km për orë, ndërsa insekti më i shpejtë është Tee Dragonfly (Pilivesa), e cila mund të lëviz me shpejtësinë 100 km/h.
- Një qen afrikan mund të vrapoj me shpejtësi 80 km/h. Nuk është kafsha më e shpejtë, por mund të vrapoj 4 orë pa ndërprerë.
- Përfundimisht, kafsha më e shpejtë e tokës është gatopardi (cheetah). Më të shpejtit në ajër janë skifteri, shqiponja dhe gjeraqina. Kurse kafsha më e shpejtë e ujit është peshkaqeni.



Qëndrim Krasniqi IV

FJALËKRYQI

	Një fe që ishin shqiptarët para Islamit	Gojëtar	Përgojim arab.	Emër mashkulli	Shkronja e parë	Prit turq.	E pranishme (që është aty)	C.I	Diqka mahnitëse
Qytet ne Shqiperi									
Kafshë					Lloj çaji / E.I				
Brendia e fytit								T / Mjet informimi	
E di atë						Kafshë pyelli / Firmë parfumerie			
Lloj sporti					I dashur ang. / V				
Pseudonim i emrit Erik				Shtete / Organi politik (shq)					
	I / Një pejgamber		Një shkronjë / Lloj sporti		Kompani Amerikane e ashensorëve / Vdes ang.				
		T.A.D. / Duhet ang.				Burim uji			
Një kontinent								N / Metal i çmuar	
Gjueti Ang							Babë / Zotëri Ang (shkurt		
J.S.I.I					Vizita e Qabes jashtë Haxhit / Shkronja e 18				
Samar ati (e kun-dërta)									

Punuar nga:
Burhanudin Kukaj & Selami Bikliqi / IV

Daniel Streich
përqafon Islamin

Politikani zvicerran ndalon minaret, pastaj konvertohet ne islam



Politikani zviceran Daniel Streich i cili u bë i famshëm, si rezultat i kundërshtimit të xhamive në vendlindjen e tij, tani ka përqafuar besimin të cilin e ka fyer.

Daniel Streich ka qenë pjesëtar i Partisë Popullore të Zvicrës, në Zvicër. Politikani i mirënjohur Streich ka udhëhequr thirrjet për ndalimin e minareve në Zvicër. Ai ka qenë aktiv në ndërtimin e ndjenjave anti-Islame në tërë Zvicrën.

Kjo fushatë mbështetëse i ka sjellë atij pozitë të lartë në ushtrinë Zvicerane.

Streich ishte pjesëtar i rëndësishëm i Partisë Popullore Zvicrane. Rëndësia e tij mund të vërehet nga ndikimi I tij në bërjen e partive politike, ku gjithmonë kishte rol të dalluar.

Lëvizja e tij kundër minareve, kishte për qëllim të fitojë vëmendje politike dhe të ketë dobi prej saj.

Ai fitoi gradën e instruktorit ushtarak në ushtrinë Zvicrane pikërisht falë popullaritetit të tij.

Ai gjithashu ishte shumë i përkushtuar ndaj Partisë së tij dhe shërbeu si politikan lokal në komunën Bulle.

Përqafimi i Islamit

Streich u përpoq të kuptoj Kur'anin dhe mësimet Islame në mënyrë që të argumentonte kundër muslimanëve në dogmat e besimit të tyre.

Në vazhdimësinë e përpjekjeve të tij, ish-krishteri filloi të pajtohet me to dhe i pranoi pohimet(ajetet) e Kur'anit.

I lindur në një familje krishtere, Streich ka bërë një studim gjithpërfshirës të Islamit, me qëllim që të dëmtoj dhe të kundërshtojë atë, por mësimet Islame kishin përplasje të thellë tek ai.

Përfundimisht ai shkëputi lidhjet e tij me aktivitetet politike dhe përqfoi Islamin.

Streich i ka klasikifuar përpjekjet kundër muslimanëve si djallëzore. Ai thotë se e ka lexuar Biblën dhe shpesh ka shkuar në kishë, por tash ai lexon Kur'anin e shenjtë dhe falë namazet pesë herë në ditë.

Përveç kësaj ai thotë se ka anuluar antarësinë e tij në parti dhe ka bërë publike konvertimin e tij.

Streich thotë se ai ka gjetur të vërtetën e jetës në Islam, të cilën nuk mundi ta gjejë në Krishterizëm.

"Islami më ofron përgjigje logjike të pyetjeve të rëndësishme të jetës, të cilat në Krishterizëm nuk i kam gjetur kurrë."-thotë Streich.

Ai tani është bërë një musliman i devotshëm, shkon në xhami, lexon Kur'anin dhe falet pesë herë në ditë.

Sipas shifrave të Unionit të Organizatave dhe Komuniteteve Islame, 3000 deri në 5000 Italianë, tashmë janë konvertuar në Islam prej Krishterizmit.

Jeta e Daniel Streich në Islam

Kohët e fundit çështja e ndalimit të minareve u fut në votim në Zvicër,ku autoritet Zvicërane , I dhanë problemit status ligjor.

Gjatë votimeve rezultatet treguan se 42.5% votuan në favor të minareve dhe 57.5% e kanë mbështetur ndalimin e tyre, përderisa muslimanët në Zvicër përbëjnë vetëm 6% të popullatës.Gjëja më mbresëlënëse në këtë vlerësim është mbështetja e 42.5% e popullësisë pasi vetëm 6% janë muslimanë.

Analistët kanë deklaruar se ndalimi I minareve dhe ritualeve Islame I ka tërhjekur njerëzit në drejtim të Islamit.

Streich tani vëmendjen e tij e ka fokusuar në pjesëmarrjen për ndërtimin e një partie të re Demokratike Konservative në kantonin e Filburgit..Lëvizja e re e Streich është në kontrast me atë të së kaluarës dhe ai ka për qëllim të promovojë tolerancën fetare dhe jetën paqësore në bashkësi, përkundër faktit se ndalimi I minareve ka fituar një status ligjor! Ai I është kundërvënë vrullshëm ndalimit të minareve dheë shpreson të vë gurthemelin e xhamisë së pestë në Zvicër, njëherit një ndër më të bukurat në Europë.

Përkthyen nga gjuha angleze:
Albulena Hajraj 13v
Hyrishahe Morina 13v

